$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{mink1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHENIM:** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.
3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e

---

përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

## **22. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përrjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për

---

kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të

---

Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

##### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

##### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## **SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					

---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërës nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

### **Specifikimet teknike gjenden bashkelidhur DST ne SPE per secilin Lot.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### **Per te gjitha produktet duhet te respektohen edhe kerkesat, si me poshte:**

Ne te gjitha paketimet e secilit produkt, te jene te shenuar afatet e prodhimit dhe skadences per nje perdorim sa me te gjate brenda nje periudhe optimale nga data e marrjes ne dorezim, te dhena mbi perberesit e produktit (sipas natyres se tij), si dhe te gjitha te dhenat e tjera qe percaktojne standardet, rregulloret dhe legjislacioni ne fuqi.

Te gjitha mallrat te jene te cilesise se larte dhe brenda standardeve.

Mallrat e kerkuara per secilin Lot, do te dorezohen nga Kontraktuesi te shoqeruara me te gjitha dokumentacionin qe percaktojne ligji dhe aktet nenligjore dhe do te merren ne dorezim dhe do te pranohen, nga nje komision i posacem i ngritur nga autoriteti kontraktor, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

---

Kontraktori do te dorezoje mallin/rat ne cilesine e kerkuar, brenda kushteve dhe standardeve teknike dhe te ambalazhuar ne menyre te pershtatshme (*sipas natyres se mallit*), te tille qe te jene te mbrojtur nga kushtet atmosferike dhe demtimet gjate transportit, si dhe duke marr te gjitha masat qe kane te bejne me zbatimin e rregulloreve perkatese, lidhur me masat higjeno-sanitare kundra virusit COVID - 19.

Kontraktori mban pergjegjesi per cilesine dhe standardet e artikujve objekt prokurimi, duke marre ne konsiderate qe keta artikuj do te perdoren nga femije qe frekuentojne cerdhet, kopshtet dhe shkollat.

Ne çmimin dhe vleren e ofertes, perfshihen ambalazhimi, transporti i mallit/ve objekt prokurimi per secilin Lot, risqet dhe pergjegjesite ndaj te treteve, si dhe te gjitha detyrimet apo kostot e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar apo praktikatat me te mira, deri ne destinacionin e kerkuar nga autoriteti kontraktor (magazina e Qendres Ekonomike te Arsimit Fier).

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

**Sasitë e pritshme të shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 12 mujore dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.**

Sasia e mallit që kërkohet:

#### **Loti 1: Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij**

1	2	3	4
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Gjalp pa kripe, i fresket	kg	6,307
2	Veze	kokrra	135,490
3	Djath i bardhe gjysme i forte	kg	5,725
4	Qumesht me yndyre të plote i sterilizuar	litër	70,780
5	Gjize pa kripe	kg	2,649

#### **Loti 2: Blerje fruta dhe perime**

1	2	3	4
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Patate	kg	20,290
2	Qepe e thate	kg	7,330
3	Karrota	kg	5,115
4	Bizele frigoriferi (mashurka)	kg	2,330
5	Presh	kg	3,273
6	Laker	kg	2,555
7	Spinaq	kg	4,790
8	Bizele fresket	kg	2,520
9	Mashurka	kg	2,110
10	Specat	kg	1,190

11	Domate	kg	1,695
12	Patllixhan	kg	1,650
13	Kastravec	kg	1,405
14	Kunguj	kg	1,275
15	Hudhra te thata	kg	33
16	Qepe te njome	kg	670
17	Lule laker ose brokoli	kg	1,140
18	Majdanoz	kg	194
19	Fruta	kg	14,570
20	Banane	kg	11,300

**Shenim:** Per zerin me numer rendor 19 “Fruta” Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten qe brenda cmimit te ofruar nga operatori ekonomik, te kerkoje fruta te ndryshme sipas stines (molle, portokalle, mandarina, pjeshka, kajsi etj.) dhe operatori ekonomik eshte i detyruar t’i pergjigjet AK.

### **Loti 3: Blerje buke**

1	2	3	4
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Buke	kg	35,290
2	Buke integrale	kg	10,820

### **Loti 4: Blerje ushqime koloniale**

1	2	3	4
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Sheqer	kg	10,180
2	Oriz	kg	12,650
3	Vaj luledielli (ushqimor)	litër	5,243
4	Miell gruri	kg	8,125
5	Miell misri	kg	1,120
6	Makarona	kg	6,805
7	Reçel i sterilizuar	kg	4,188
8	Marmalate fiku	kg	1,030
9	Niseshte	kg	592
10	Kripe	kg	1,503
11	Lenge domate (salce, pure domate) 700 gr	cope	2,397
12	Sode buke 100 gr	cope	7,360
13	Pluhur pjekje (13 gr)	cope	3,230
14	Vanilje (13 gr)	cope	1,030
15	Limontoz (100 gr)	cope	4,250
16	Fasule	kg	3,432



17	Thjerreza	kg	2,224
18	Çaj	kg	168
19	Rigon (100 gr)	cope	3,190
20	Piper i zi (100 gr)	cope	440
21	Vaj ulliri	litër	3,846
22	Uthull molle	litër	352
23	Kanelle (100 gr)	cope	4,290
24	Trahana	kg	1,603
25	Tershere	kg	1,253

### **Loti 5: Blerje mishi dhe nënproduktet e tij**

1	2	3	4
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Mish vici i fresket	kg	15,805
2	Mish pule i fresket	kg	5,260
3	Sallam /salçiçe	kg	720

#### **Afatet e levrimit:**

**12 (dymbëdhjete) muaj nga nënshkrimi i marreveshjes kuader.**

#### **Grafiku i levrimit:**

Lëvrimi i mallit do të behet sipas kërkesës dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor.

Operatori ekonomik fitues për secilin Lot duhet të marrë masa për furnizimin e AK për plotësimin e nevojave të përditshme të **kopshteve, çerdheve, konviktit dhe shkollës Horizont** në administrim të QEA, Bashkia Fier.

**Vendi i ekzekutimit të kontratës:** Magazina e Qendres Ekonomike të Arsimit, Bashkia Fier, Fier, Shqipëri.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **LOTI 1: BLERJE BULMETI DHE NËNPRODUKTET E TIJ**

#### **FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

##### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
- **Shënim:** Bashkimi i operatoreve ekonomike që do të rezultojë fitues, pas procedurës së prokurimit do të dorëzojë pranë AK, para lidhjes së kontratës dokumentacionin si më poshtë (*ne perputhje me nenin 14, pika 2 të ligjit nr.162/2020*):

- a. Marrëveshja e **noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme e **noterizuar**.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

---

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:**

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2019, 2020**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2019, 2020**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **30 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlogaritur të Lotit 1 që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **6 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të Lotit 1 që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtem:

**a-** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara

**ose**

**b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për produktet me origjinë shtazore Licencë të **kategorisë II.1.A.1** – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” **ose** Licence të **Kategorisë**

---

**II.1.B** ”Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez” per objektin e prokurimit bulmet dhe nenproduktet e tij. *(Nuk lejohet perdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

**2.3.3** Operatori duhet të ketë në pronësi (vertetuar me aktin e pronesisë ose kopje e noterizuar) ose me qera, ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara të shoqeruara me dokumentacionin ligjor përkatës, ambiente të përshtatshme për prodhimin ose tregëtimin e produkteve të bulmetit, ku të ketë ambiente frigoriferikë i pajisur me leje higjieno-sanitare të lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

**Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK, ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.**

**2.3.4** Ofertuesi duhet të ketë në pronësi, ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e produkteve të bulmetit, si me poshte:

**1 (nje)** automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV) per produktet e bulmetit. Per automjetin te paraqitet certifikata e pronesisë ose kontrata e dhurimit ose e perdorimit apo te qirase sipas rastit, si dhe dokumentacioni përkatës: Certifikata e kontrollit teknik, leje e qarkullimit dhe siguracion te automjetit ne dispozicion, leje per transport mallrash si dhe leja higjieno-sanitare e mjetit. (Dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

**Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.**

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikatat per objektin e prokurimit sipas Lotit, si me poshte:

- Çertifikatë ISO 9001-2015, ose ekuivalente me te
- Certifikate ISO 22000-2018 ose ekuivalente me te

Çertifikatat duhet të jenë në fuqi, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

---

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Per kete O.E duhet te paraqese **vetëdeklarim** ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shenim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues prane AK, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore. (*Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 dhe ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021).*

**Shënim:** Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojne per me shumë se nje LOT, duhet te plotesojne kriteret e veçanta, si shumë të LOTEVE për të cilat konkurrojnë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **LOTI 2: BLERJE FRUTA DHE PERIME**

### **FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

---

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.
- **Shënim:** Bashkimi i operatoreve ekonomike që do të rezultojë fitues, pas procedurës së prokurimit do të dorëzojë pranë AK, para lidhjes së kontratës

---

dokumentacionin si me poshte (ne perputhje me nenin 14, pika 2 te ligjit nr.162/2020):

- a. Marrëveshja e **noterizuar**, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme e **noterizuar**.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:**

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2019, 2020**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2019, 2020**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **14 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të Lotit 2 që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.



---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **2 900 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të Lotit 2 që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara  
**ose**
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për produktet me origjinë bimore **Kategoria II.1.C, kategoria "Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve", nenkategoria "Prodhimi primar me shumice"** për objektin e prokurimit fruta dhe perime. (Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument për pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, të ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjieno-sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

**Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.**

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e fruta perimeve, **1 (nje)** automjet te pershtatshem ATP te pajisur me dokumentacionin ligjor: certifikata e pronësisë ose kontrata e dhurimit apo e qirase sipas

---

rastit si dhe dokumentacionin perkates: certifikate e kontrollit teknik, leje e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit ne dispozicion, leje per transport mallrash si dhe leja higjieno-sanitare e mjetit. (Dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

**Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr.710, date 24.11.2021.**

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese certifikatat per objektin e prokurimit sipas Lotit, si me poshte:

- Çertifikatë ISO 9001-2015, ose ekuivalente me te
- Certifikate ISO 22000-2018 ose ekuivalente me te

Çertifikatat duhet të jenë në fuqi, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Per kete, O.E. duhet te paraqese **vetëdeklarim** ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

